



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA TEKNIKE

Nr. 759/2 Prot

Tiranë, më 24/03/2015

Lënda: Sqaruese për qëllime tatimore mbi veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësore privat

Drejtuar: **DHOMES KOMBËTARE TE PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVATË**
Adresa: Blv. Zhan D'Ark, kulla 1, "Teknoprojekt", Shk.1, Ap. 9,

DREJTORISË RAJONALE TATIMORE

Për dijeni: **Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve**
Drejtoria e Vleresimit të Ardhurave dhe Kontabilitetit
Drejtoria e Kontrollit Tatimor
Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit
Drejtoria Ligjore
Drejtoria e Hetimit Tatimor
Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsioni)
Drejtoria e Menaxhimit të Riskut
Drejtoria e Auditit të Brendshëm
Drejtoria e Teknologjise së Informacionit
Drejtoria e Apelimit Tatimor
Avokati i Tatimpaguesve
Drejtoria Teknike

KËTU

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, lidhur me dokumentimin dhe trajtimin për efekte fiskale të transaksioneve që kryejnë përmbaruesit gjyqësor në kuadër të zbatimit të detyrave dhe ushtrimit të drejtave të përcaktuara në Ligjin Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", në vijim të shkresës Nr. Prot. 2044, datë 28.01.2015 si dhe shkresës Nr 759, datë 13.01.2015 të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat, për të siguruar zbatimin korrekt të dispozitave të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" si dhe përshtatjes së dispozitave të Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", gjykon te nevojshme te sqaroje si më poshtë:

1. Rregulla të përgjithshme sipas legjislacionit të fushës.

Subjektet përmbaues gjyqësor privat, të cilët e kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin Nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, bazuar në nenin 32 të këtij ligji veç të tjerave kanë detyrimin të kryejnë për subjektet fizike ose juridike veprimet e nevojshme, që synojnë realizimin e së drejtës së tyre dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme.

Referuar nenit 40 të këtij ligji, marrëdhëniet ndërmjet përmbauesit gjyqësor privat dhe palës kreditore rregullohen mbi bazën e kontratës së lidhur mes tyre, në të cilën përcaktohen detyrimet reciproke mes përmbauesit gjyqësor privat dhe kreditorit.

Bazuar në nenin 47 dhe 48 të Ligjit, llojet e shërbimeve përmbauesore të tarifuara si dhe tarifat përkatëse përmbauesore për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, ose të veprimeve përmbauesore teknikisht dhe ligjërisht specifike janë përcaktuar me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave Nr. 1240/5 datë 15.09.2009 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbauesor gjyqësor privat”.

Për shërbimet përmbauesore të kryera në përputhje me veprimet procedurale sipas dispozitave ligjore, udhëzimin dhe kontratën përkatëse, përcaktohen qartë detyrimet e palëve përkatësisht kreditorit dhe debitorit, të cilët ngarkohen të paguajnë tarifën përmbauesore.

Pavarsisht subjektit (kreditorit ose debitorit) i cili në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore mban barrën (ngarkohet) për pagesën e tarifës për shërbimin përmbauesor ndaj përmbauesit gjyqësor privat, përmbauesi nëpërmjet llogarisë bankare arkëton pagesën për veprimet procedurale siç përcaktohet në Udhëzimin Nr.1240/5 datë 15.09.2009. Subjekti përmbaues mban dhe paraqet me kërkesë të debitorit apo të kreditorit kërkesë, prova dokumentuese për kostot e përmbauesit.

Bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr.10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, përmbauesi gjyqësor privat është i detyruar që gjatë punës së tij të deklarojë dhe të kryejë, në llogari rrjedhese bankare, të gjitha veprimet financiare që kanë të bëjnë me procedurat e ekzekutimit dhe të dokumentojë dhe provojë çdo veprim bankar të kryer si me kreditorin ashtu edhe me debitorin.

Sipas Udhëzimit Nr. 1240/5 datë 15.09.2009 subjekti përmbaues fillon procedurën e ekzekutimit me kërkesë të kreditorit, i cili është i detyruar të përmbushë detyrimet e tij lidhur me vlerën e shërbimit përmbauesor sipas kontratës të shërbimit të lidhur me shoqërinë përmbauese/përmbauesin gjyqësor privat, miratuar me Urdhër Nr. 8543/2 date 01.11.2010 të Ministrisë të Drejtësisë.

2. Aplikimi për qëllime tatimore sipas legjislacionit tatimor

Referuar rregullave të mesiperme të legjislacionit të fushës, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar, bazuar në paragrafin VIII të Udhëzimit Nr.1240/5 datë 15.09.2009, TVSH-ja e cila aplikohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr 92/2014, date 24.07.2014, “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë”, i shtohet tarifës së aplikuar nga subjekti përmbauesor privat.

Përmbauesi privat bazuar në nenet 31-33 dhe 99 të Ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë” detyrohet të lëshojë faturë tatimore shitje për çdo transaksion të kryer me kreditorin kërkuar ku llogarit, deklaron dhe paguan TVSH-në përkatëse

sipas këtij ligji. Subjekti kreditor kur është person i tatueshëm, ushtron të drejtën për zbritjen e TVSH-së së faturuar për shërbimin e përmbaruesit në përputhje me nenet 68-76 të Ligjit Nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, dhe dispozitave përkatëse të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 në zbatim të tij.

Referuar pikës IV të Udhëzimit Nr.1240/5 datë 15.09.2009, në momentin e kryerjes ose arkëtimit të pagesës së tarifës përmbarimore prej debitorit sipas mënyrave të përcaktuara dhe të provuara sipas ligjit, përmbaruesi lëshon faturën tatimore të shitjes me TVSH për debitorin për vlerën e tarifës përmbarimore të paguar efektivisht prej këtij të fundit dhe lëshon faturën-notë krediti për kreditorin për shumën e kthyer këtij të fundit, duke saktësuar në ulje për vlerën e kthyer faturën tatimore të shitjes të lëshuar më parë për kreditorin.

Kreditori nga ana e tij regjistron dhe deklaron në librin e blerjes dhe deklaratën e TVSH-së, faturën notë krediti duke saktësuar në ulje tvsh-në e zbritshme nëse e ka deklaruar te zbritshme TVSH-në e faturës së lëshuar prej përmbaruesit për kreditorin, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për TVSH-në”.

Përmbaruesi lëshon faturë - notë krediti për kreditorin edhe në rastet kur detyrohet ti kthejë tarifën kreditorit (nëpërmjet llogarisë bankare) për arsye të tjera nga sa më sipër, të parashikuara në Ligjin Nr.10031 datë 11.12.2008 dhe aktet në zbatim të tij. Kështu fatura e lëshuar saktëson në ulje për kreditorin tarifën e paguar prej tij për vlerën e veprimeve procedurale që i kthehet mbrapsht efektivisht nga ana e përmbaruesit.

Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat, bazuar në nenin 19 “Fitimi i tatueshëm” të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Udhëzimit në zbatim të tij, për përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një periudhe tatimore do të shërbejë si bazë bilanci kontabël dhe anekset e tij të hartuara sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe dispozitave të ligjit të sipërcituar. Bazuar në pikën 3.4 të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar sipas të cilit, fitimi ose e ardhura neto e tatueshme del si rezultat i diferencës midis të ardhurave totale (të ardhura nga aktiviteti normal dhe të ardhura të jashtëzakonshme) me shpenzimet e kryera me qëllim realizimin dhe ruajtjen e të ardhurave, kështu të ardhurat nga shërbimet përmbarimore të tarifuar në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Nr 1240/5, datë 15.09.2009 dhe të dokumentuara si më sipër, janë të ardhura të tatueshme për qëllime të tatimit mbi të ardhurat.

Përsa është sqaruar më sipër, Drejtuesit e Drejtorive Rajonale Tatimore dhe drejtorive në DPT të marrin masa të menjëherëshme organizative për shpërndarjen dhe njohjen me përmbajtjen e shkresës të punonjësve të administratës tatimore, si dhe sqarimin e tatimpaguesve lidhur me objektin e zbatimit të shkresës.

Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve në zbatim të nenit 28 “Informimi i publikut” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën Shqipërisë”, i ndryshuar, publikon këtë shkresë në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve www.tatime.gov.al.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

BRISIDA SHEHAJ